

	REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA KOMUNA E RAHOVECIT OPSTINA ORAHOVAC MUNICIPALITY OF RAHOVEC	
---	--	---

Për:	Operatori Ekonomik: PROGLOBAL SH.P.K. me adresë në PRISHTINE Operatorëve Ekonomik Të gjitha palëve të interesuar
Nga:	Astrit Mullabazi, Menaxher i Zyrës së Prokurimit
Lënda:	VENDIM për Rishqyrtim të Kërkesës
Datë:	27.04.2026

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Rahovecit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 63 paragrafi 1 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurim Publik, sa i përket **Kërkesës për Rishqyrtim** të datës: **24.04.2026**, të parashtruar nga Operatori Ekonomik: **PROGLOBAL SH.P.K.** me adresë në **PRISHTINE**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Servisimi dhe mbushja e aparateve zjarrfikëse**, me Numër të prokurimit: **623-26-1613-2-3-6**, Numër i brendshëm: **623-26-001-2-3-6**, nxjerr:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** e pa bazuar kërkesa e parashtruar nga Operatori Ekonomik: **PROGLOBAL SH.P.K.** me adresë në **Prishtinë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Servisimi dhe mbushja e aparateve zjarrfikëse**, me Numër të prokurimit: **623-26-1613-2-3-6**, Numër i brendshëm: **623-26-001-2-3-6**, kundër Njoftimit mbi Vendimin e AK-së, të datës: **20.04.2026**, të publikuar në ueb-faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>
- II. Autoriteti Kontraktues vendos të vazhdoj me Njoftim Mbi Vendimin e Autoritet Kontraktues për aktivitetin e prokurimit, me Numër të prokurimit: **623-26-1613-2-3-6**, Numër i brendshëm: **623-26-001-2-3-6**
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronik në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

ARSYETIM

Operatori Ekonomik: **PROGLOBAL SH.P.K.** me adresë në **Prishtinë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Servisimi dhe mbushja e aparateve zjarrfikëse**, me Numër të prokurimit: **623-26-1613-2-3-6**, Numër i brendshëm: **623-26-001-2-3-6**, kundër Njoftimit mbi Vendimin e AK-së, të datës: **20.04.2026**, të publikuar në ueb-faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>, ka bërë Kërkesë për Rishqyrtim me datë: **24.04.2026**, sipas nenit 108/A, të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) me Nr. 04/L-042.

Baza Ligjore për Refuzim të Kërkesës

Ju sqarojmë se pretendimet e tua ankimor nuk qëndrojnë dhe janë të pabazuar, pasi që vlerësimi i ofertave është bërë konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik

Autoriteti Kontraktues: Komuna e Rahovecit, ju ka Njoftuar juve si Operator Ekonomik ankues, sipas formularit **B42 Letër Standarde për tenderuesin e eliminuar**, ku kemi cekur:

Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye:

Sqarimet janë si në vijim:

Gabimet aritmetikor i evidentuar është më shumë se dy përqind (2%) i vlerës totale të ofertës;

Tek Përshkrimi i Çmimeve është kërkuar që çmimi të llogaritet për dy (2) servise në vitë

Nr	Lloji i paisjeve	Njësia Matëse	Sasia	Servisim Dy (2) në vitë	Gmimi për Njësi me TVSH	Gjithsej Vlera me TVSH

Në ofertën e juaj të dorëzuar keni llogaritur vetëm Sasinë * Çmimin për njësi me TVSh dhe në total oferta juaj është: 5,783.00 Euro, ndërsa nga ne si AK është kërkuar:

Sasinë * Çmimin për njësi me TVSh * Servisimi dy (2) në vite, dhe sipas Ofertës tuaj çmim për njësi, totali duhet të ishte: 10,566.00 Euro;

Rregullore Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, Neni 40.9, pika b. thotë: *Ne rast se shuma e korrigjuar është me shume se +/- 2%, AK do të eliminoj OE dhe do të informoj me shkrim OE në fjalë duke përdorur formën standarde B42.*

Pretendimi Nr. 1 & 2 Ankimor:

Pretendimi ankimor 1:

Juve si AK – Komuna Rahovec, me arsyetimin e eliminimit te ofertës sone besojme se për qellim te caktuar keni llogaritur gabimisht vlerën dhe tentoni ta anuloni procesin për te favorizuar kompani te caktuar, pasi qe oferta jone financiare nuk ka kurrefare gabimi aritmetik por qe është ofertuar konform kerkesave dhe njësite te percaktuara ne oferte financiare – paramase dhe parallogari.

Çmimi për njësi për pozicionin e pare ne vlere prej 8.50 € është ofruar si kosto e cila i mbulon dy servisime pergjate teresis se vitit apo ashtu siç eshte kerkua ne DT dhe Aneksi 1 dhe atë si me poshte.

Nr	Lloji i paisjeve	Njësia Matëse	Sasia	Servisim Dy (2) në vitë	Gmimi për Njësi me TVSH	Gjithsej Vlera me TVSH
1	Servisimi dhe rimbushja sipas nevojës e aparatit për shurje të zjarrit, P-9	Copë	340	2	8.50	2890.00
2	Servisimi dhe rimbushja sipas nevojës e aparatit për shurje të zjarrit, P-6	Copë	129	2	8.50	1096.50
3	Servisimi dhe rimbushja sipas nevojës e aparatit për shurje të zjarrit, P-30	Copë	7	2	8.50	59.50
4	Servisimi dhe rimbushja sipas nevojës e aparatit për shurje të zjarrit, P-50	Copë	2	2	8.50	17.00
5	Servisimi dhe rimbushja sipas nevojës e aparatit për shurje të zjarrit, CO2- 5 kg	Copë	80	2	9.00	720.00
6	Furnizim me ekstarkt 3% për formimin e shkumës për shurje të zjarrit	Litra	200	1	5.00	1000.00
Totali:						5783.00

Vlera totale për pozicionin 1 është llogaritur si ne vijim 340 (sasia) për 2 servisime (njesi) me cmimin e dhënë ne vlere prej 8.50, ku totali është prej 2,890.00 €.

Ky kalkulim është aritmetikisht i saktë në raport me shifrat e paraqitura në rresht dhe jo vetëm ne pozicionin 1, por edhe për pozicionet tjera ku është pershkuar numri i servisimeve, si rrjedhoj e kesaje juve si AK – Komuna Rahovec , keni eliminuar kunderligjeshem ofertën tone.

Pretendimi ankimore 2:

Sipas nenit 59.4 të LPP-se dhe nenit 40.9, të Rregullores nr. 001/2022, për Prokurim Publik çmimi për njësi i ofruar nga Operatori Ekonomik, konsiderohet si çmim mbizotërues dhe se çmimi yne për njësi përfshin të gjitha kërkesat e Dosjes së tenderit dhe përfshinë dy servisimet, ashtu siç është përcaktuar nga juve si AK, në paramasë dhe paralogari dhe si i tillë nuk ka të drejtë të ndryshohet totali, përkatësisht është përdoruar formula e krijuar nga ju si AK.

Eliminimi si i tillë, paraqet shkelje esenciale të dispozitave ligjore, siç është nenin 56.3 i LPP-se, përkatësisht neni 40.12, i Rregullores nr. 001/2022, për Prokurim Publik ku shprehimisht përcaktohet:

- *“Tenderuesi nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedura e prokurimit në bazë të ndonjë kërkesë apo kriteri që nuk është specifikuar në njoftimin e kontratës / dosjen e tenderit”.*

Pra juve si Autoriteti Kontraktues keni eliminuar gabimisht apo edhe qëllimisht kompanin tone, duke vendosur kriterë apo kushte të cilat nuk kanë qenë pjesë e Dosjes së Tenderit dhe se arsyetimi i eliminimit i përshkruar si në leter standarde tregon për tentativa për lajthitje e cila nëse deponohet në instanca përkatëse apo nëse auditohet mund të jetë e demshme për zyren e prokurimit të AK – Komuna Rahovec dhe mund të nxjerrë përgjegjës zyrtarët përkatës të prokurimit së bashku me anëtarët e komisionit vlerësues të ofertave.

Llogaritja dhe përshkrimi i vlerës totale prej 5,783.00 €, (për 2 servise në vit) është matematikisht i saktë në raport me sasinë dhe çmimet për njësi të ofertuara dhe se nuk ekziston asnjë gabim në mbledhje apo shumëzim të shifrave të paraqitura nga ne si kompani dhe çdo tentativë për eliminimin e ofertës sonë do të procedohet tutje në instanca përkatëse.

Arsyetimi i juaj për "korigjimin" e ofertës sonë duke aplikuar formulë që nuk figurojnë në formularin e çmimeve, duke e dyfishuar totalin e ofertës sonë nuk përbën përmirësim të gabimit aritmetik, por ndërhyrje në substancën ekonomike të ofertës gjë që ndalohej shprehimisht me ligj.

Nëse juve si AK, kishit dyshime mbi atë se a mbulon çmimi për njësi një të dyja servisimet, do duhej të kërkonit sqarim sipas nenit 72 të LPP-së, e jo të supozonit gabimin dhe të rrisni artificialisht vlerën e ofertës në 10,566.00 € për të krijuar bazë për eliminim dhe ofrim të mundësive të ofertimit të kompanisë të favorizuara në mënyrë të hapur.

Oferta e kompanisë sonë është aritmetikisht e saktë dhe plotëson kërkesat e Dosjes së Tenderit, përkatësisht arsyetimi i juaj si AK-së për anulim të aktivitetit të prokurimit në mënyrë të tillë pa u plotësuar asnjëri kusht ligjor nga neni 62 i LPP-se, konsiderohet si shkelje e rëndë e dispozitave ligjore në fuqi dhe është i sanksionuar me nenin 97, të Rregullores për Prokurim Publik.

Prandaj bazuar në atë që u përshkrua si më lartë dhe në mënyrë që të evitojmë procedurat tjera në instanca tjera propozojmë AK – Komuna Rahovec, dhe zyrtarët përgjegjës të prokurimit të ndermarrin veprimet ligjore dhe të nxjerrin këtë:

Përgjigje në Pretendimi Nr. 1 & 2 Ankimor:

Sa i përket pretendimit tuaj ankimor se: *Juve si AK – Komuna Rahovec, me arsyetimin e eliminimit të ofertës sonë besojmë se për qëllim të caktuar keni llogaritur gabimisht vlerën dhe tentoni ta anuloni procesin për të favorizuar kompani të caktuar*

Me **20.04.2026**, AK: Komuna e Rahovecit, ka publikuar: B58 Njoftimin mbi Vendimin, ku në Rezultatit të aktivitetit të prokurimit: Autoriteti Kontraktues: KOMUNA E RAHOVECIT, **ANULON**

aktivitetin e prokurimit: *Një dispozitë në Ligjin e Prokurimit Publik kërkon Anulimin e aktivitetit të prokurimit; Neni 43.5, e RREGULLORES Nr. 001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK, thotë: asnjëri prej tenderëve të pranuar nuk është i përgjegjshëm;*

Po ashtu sa i përket pretendimit tuaj se: *Vlera totale për pozicionin 1 është llogaritur si ne vijim 340 (sasia) për 2 servisime (njësi) me cmimin e dhënë ne vlere prej 8.50, ku totali është prej 2,890.00 €.*

Ky kalkulim është aritmetikisht i saktë në raport me shifrat e paraqitura në rresht dhe jo vetëm ne pozicionin 1, por edhe për pozicionet tjera ku është përshkruar numri i servisimeve, si rrjedhojë e kësaj juve si AK – Komuna Rahovec , keni eliminuar kundërligjshëm ofertën tone.

Ashtu siç ju kemi informuar me formularin: **B42 Letër Standarde për tenderuesin e eliminuar**, ku kemi cekur: **Në ofertën e juaj të dorëzuar keni llogaritur vetëm Sasinë * Çmimin për njësi me TVSh dhe në total oferta juaj është: 5,783.00 Euro, ndërsa nga ne si AK është kërkuar:**

Sasinë * Çmimin për njësi me TVSh * Servisimi dy (2) në vite, dhe sipas Ofertës tuaj çmim për njësi, totali duhet te ishte: 10,566.00 Euro;

I njëjti Përshkrimi i çmimeve ka qenë edhe ne vitin 2025 ku ju si Operator Ekonomik pjesëmarrës e keni ofruar:

Servisimi dhe Blerja e Aparateve për Shuarjen e Zjarreve

Nr	Lloji i paisjeve	Njësia Matëse	Sasia	Servisim Dy (2)	Gmimi për Njësi me TVSH	Gjithsej Vlera me TVSH
1	Terja dhe përpunimi i pluhurit për Aparatin për shuarjen e zjarrit, P-9	Copë	340	2	1.50	1020.00

*Ku në ofertën e juaj keni kalkuluar: Sasia * Çmimi për Njësi me TVSh * Dy (2) Servisime = 340 * 1.50 * 2 = 1020.00 €*

Të njëjtën Ofertën e keni bërë dhe **në vitin 2024,**

Servisimi dhe Blerja e Aparateve për Shuarjen e Zjarreve						
Nr	Lloji i paisjeve	Njësia Matëse	Sasia	Servisim Dy (2)	Gmimi për Njësi me TVSH	Gjithsej Vlera me TVSH
1	Terja dhe përpunimi i pluhurit për Aparatin për shuarjen e zjarrit, P-9	Copë	340	2	0.70	476.00

*duke kalkuluar: Sasia * Çmimi për Njësi me TVSh * Dy (2) Servisime = 340 * 0.70 * 2 = 476.00 €*

Po ashtu **në vitin 2022** keni qenë vetë **ekzekutuesi i kontratës:** Servisimi i Aparate për Shuarjen e Zjarreve, ku keni pasur këtë ofertë:

Servisimi dhe Blerja e Aparateve për Shuarjen e Zjarreve

Nr	Lloji i paisjeve	Njësia Matëse	Sasia	2 herë Servisim	Çmimi	Gjithsej Vlera (D*E*F)
1	Terja dhe përpunimi i pluhurit për Aparatin për shuarjen e zjarrit, P-9	Copë	340	2	0.7	476.00

*Sasia * Çmimi për Njësi me TVSh * Dy (2) Servisime = 340 * 0.70 * 2 = 476.00 €*

Pretendimi juaj është i pabazuara

Nga konstatimet e lartcekur u vendos si në dispozitive të këtij Vendimi.

Kjo procedurë është trajtuar konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik ne Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij **vendimi të AK-së ju munde të paraqitni** ankesë pranë OSHP-së në pajtim me nenin 109 të LPP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas vendimit të lëshuar nga Autoriteti Kontraktues.

Vendimi Publikohet:

Në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>